

VENDIM
Nr. 390, datë 12.6.2019

**PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT PËR NEGOCIIMIN E
NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT
STRATEGJIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “MICROSOFT CORPORATION”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negociimin e nënshkrimit të rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “*Microsoft Corporation*”.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe